



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 17 i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale (Ligji Nr.06/L-092 botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 03.04.2019), neni 32 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit në seancën e mbajtur me dt. 31.01.2024, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratohet ky:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATËSHKURT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni I

EMËROHET komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, lokalit afaristë – bufeja në shtëpinë e Kulturës në ngastrën kadastrale P-70604014-00771-0 ZK Dragash – në përbërje prej:

1. Isljam Redzeplari, nga ekzekutivi;
2. Brendi Berisha, nga ekzekutivi;
3. Artan Loshaj - anëtar nga Kuvendi i Komunës;
4. Ventaza Esati anëtare nga Kuvendi i Komunës;
5. Nuridin Halili përf. i OJQ-së, “GURI I ZI”;

Neni II

Detyrë e Komisionit është që të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore me të cilat parashihet dhënia në shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme e Komunës, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat tjera ligjore të cilat janë në fuqi. Komisioni është i obliguar që në ankand ti parashih qartë kushtet dhe kriteret për të aplikuar në këtë ankand, të cilat janë paraparë me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.

Neni III

Kryetar i këtij komisioni është eksperti – i emëruari i parë ose eksperti të cilin e zgjedhin vetë anëtarët e këtij komisioni.

Neni IV

Administrata e Komunës është e obliguar që të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim të efikasitetit të punës së Komisionit.

Neni V

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni VI

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Komisionit për vlerësim, të gjithë anëtarëve;
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-2025-10/24

Dt. 31.01.2024

Kryesuesja e Kuvendit:

Arijeta Skeraj



A. Skeraj